



## **BASHKIA TIRANË KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr.21, datë 23.05.2016

**Për**

### **“KRIJIMIN I KËSHILLIT ARTISTIKO – KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “d”, nenit 25, pikat 2 dhe 4, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 121, pika 1, 124, pika 1, nenit 125 dhe nenit 126, pika 1 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 për “Krijimin e Këshillave Artistiko – Kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve nr.1, datë 24.05.2005 për “Mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”; Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr. 58, datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016–2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”; Vendimit të Këshillit Bashkiak, Tiranë nr.12, datë 11.03.2016 “Rregullore mbi financimin e projekteve kulturore, artistike, rinore dhe sportive”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

### **V E N D O S I**

1. Të miratojë përbërjen e Këshillit Artistiko–Kulturor, për periudhën 2016 –2018, me përbërje si më poshtë:

- |                    |  |
|--------------------|--|
| 1. ROBERT NDRENIKA | Aktor “ Artist i Popullit”                                   |
| 2. ILIR KERNI      | Drejtor i Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit             |
| 3. YLLI TOMORRI    | Trajner  |
| 4. YLLKA MUJO      | Aktore   |
| 5. ARMINO FAJA     | Regjizor   |
| 6. BUJAR SHEHU     | Trajner “Mjeshtër i Merituar Sporti”                         |
| 7. HELIDON HALITI  | Piktor   |
| 8. EMILIANO LULE   | Themelues i Shoqatës “Visum”                                 |
| 9. HERIDA DURO     | Drejtor i krijmtarisë artistike dhe edukimit përmes Kulturës |

2. Pagesa për çdo anëtar të Këshillit Artistiko - Kulturor është 4.500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Drejtoria e Sporteve Profesionale dhe Komunitare, Drejtoria e Rinisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.10, datë 30.04.2014 për “Krijimin e Këshillit Artistiko – Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, revokohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**